

Data 22.04.2024

Procesverbal - Tipi i kontrates - Punë

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashk dokumentat e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: *Rrethim varreza Laknas dhe shtrim rrugë në Paskuqan*

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):)_ 45233120-6 Punime ndërtimi në rrugë

Afati i realizimit të punimeve është **77(shtatedhjetë e shtate) dite kalendarike**, sipas grafikut te punimeve.

Garancia per mbulimin te difekteve ,që mund te lindin gjatë shfrytëzimit të objektit , nga ana e firmës të jetë **2(dy) vjet** .

VLERA E FONDIT LIMIT – 13,333,333(trembëdhjetë milion e treqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre) lekë pa tvsh.

Argumentimi : Përlllogaritja e vlerës limit të kontratës është referuar në preventivin e përlllogaritur mbështetur në VKM nr. 629, datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”.

Në bazë të Nenit 21, pika 2, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; Nenit 2, pika 2/c si dhe Nenit 78, pika 2, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Autoriteti Kontraktor, **Ndermarrja Pastrim Gjelberim e Treg Kamez**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

b. *Formulari i ofertes sipas Shtojce 1*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme për sigurimin e ofertës mbështetet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 83, pika 1 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni II, Neni 30, pika 1.

Kërkesa për Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit bazohet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 82 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni II, Neni 26.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Përshatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale: S

- Plotësimi i kapaciteteve ligjore nga operatorët ekonomikë dhe vërtetimi se ata kanë zotësi juridike për të lidhur kontrata prokurimi, bëhet me anë të paraqitjes prej tyre të deklaratës mbi përmbushjen e kritereve të përgjithshme, sipas **shtojcës 8 të DST**

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në Nenin 77, pika 1/a dhe pika 2, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; si dhe Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Vërtetim për deklarinimin e xhiros vjetore, të konfirmuara me vulë pranë autoriteteve përkatëse (Administratës Tatimore) të tre viteve të mëparshme (**2021, 2022, 2023**), në të cilat duhet të rezultojë se vlera e xhiros minimale vjetore të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit që prokurohet (vlera e kontratës që prokurohet).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zotëron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë :

Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë :

- vlerën e përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar, bazuar në shkronjën “b”, të pikës 2, të nenit 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 1, të nenit 43 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet **financiare 2021, 2022,2023** të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009, neni 41, pika”c”, “Për auditimin

ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku bilancet e dy viteve, *kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit*.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 10091 datë 5.3.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” i ndryshuar. AK mund të kërkojë nga OE pjesëmarrës në një procedurë prokurimi të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojë raportet nëpërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve, është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë: 28. 12. 1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave, nr. 5, datë: 30. 01. 2006 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar nenin nr. 29, të ligjit nr. 8438, datë: 28. 12. 1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: Çdo tatim-pagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatim-paguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në Udhëzimin e Ministrit të Financave, në zbatim të këtij ligji.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB-së.

*Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas Shtojcës 8.

Shënim: Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor do të kërkojë ofertuesit i kualifikuar i pari dorëzimin e dokumentacionit të mësipërm.

2.2.3 Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2023 sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, (i ndryshuar). Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB. *(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit, dokumentet përkatëse vërtetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar sipas Nenit 76 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; Kreut V, Seksioni III, Nenin 43, pika 6 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” si dhe sipas Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar). Njësia e Prokurimit argumenton se pika 3 është vendosur në kuadër të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e Taksave Vendore” (i

ndryshuar), Neni 5, gërma “c” ku citohet se: “...përcakton numrin e kësteve të pagimit të taksës dhe afatet e kryerjes së tyre, si dhe kushtet lehtësuese në rastet e pagesës së plotë dhe përpara afateve të detyrimeve fiskale”.

2.3 Kapaciteti teknik

Për sa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori/t Ekonomik duhet të përmbushë/in kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor si më poshtë:

2.3.1 Përvojë të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon të paktën:

- a) Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më e vogël se 50% e vlerës se përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundi, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;
Dhe /ose
- b) Punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpallje së njoftimit të kontratës, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpermendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cili prej tyre do të përmbushë këtë kusht. Kurse pika 2.3.1b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

2.3.2 Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomik duhet të paraqesin:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, Operatori/et Ekonomik duhet të paraqes/in si dëshmi, vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohet vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, dokumentacionin e mëposhtëm:
 - Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas Shtojcës nr. 9, të DST,
 - Kontratën/at e Sipërmarrjes;
 - Situacionin përfundimtar të objektit;
 - Akt kolaudimi objekti;
 - Fatura tatimore.
 - Çertifikaten e marrjes ne dorezim/Çertifikatën e Përkohshme të marrjes ne dorezim.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, Operatori/t Ekonomik duhet të të paraqesë/in si dëshmi, vërtetime për përmbushjen me sukses të kontratës, ku shënohet

vlera, afati i përfundimt të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet në legjislacionin në fuqi, dokumentacionin e mëposhtëm:

- Kontratën/at e Sipërmarrjes;
- Situacionin përfundimtar të objektit shoqëruar me faturën;
- Akt kolaudimi objekti;
- Fatura tatimore
- Çertifikaten e marrjes ne dorezim/Çertifikatën e Përkohshme të marrjes ne dorezim.

1.3 Per kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë: Kontraten e Bashkimit te operatoreve ekonomik si dhe prokuren e posacme te deklaruar ne fazen e tenderimit.

1.4 Per kontratat e realizuara si Nënkontraktor, Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë: Kontratën baze ndermjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor;

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Argumentimi:

Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77 pika 4 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” ku përcaktohet se: “Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. “Në nenin 39 “Kërkesat të veçanta për kontratat për punë publike” pika 5 dhe 8 te VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” ku përcaktohet se: “Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës; b) punë të ngjashme deri në një kufi,ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme. Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës. “Njësia përcaktoi kriteret për punë të ngjashme si më lart duke qenë se këto kritere janë të detyrueshme, janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës. Sipas këtij neni, njësia e prokurimit vlerëson se duhen kërkuar disa

prej dokumentacioneve ligjore të zbatimit të punimeve, bazuar në Ligjin Nr. 8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e ndërtimit” (i ndryshuar), si dhe akteve në zbatim të tij, pasi duke qenë se kontrata për punë publike që po prokurohet është në bazë të punimeve me matje, sipas nenit 39 pika 1/a e VKM-së nr. 285 datë:19. 05. 2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, lind e nevojshme që operatorët ekonomikë pjesëmarrës krahas dokumentacionit të përcaktuar në nenin 39 pika 5/a dhe b, të kësaj VKM-je, të paraqesin dhe situacionet përfundimtare si dhe formular vlerësimi për punët e kryera me entet publike, për të pasur mundësi të bindet nëse operatori ekonomik zotëron përvojën e nevojshme për zbatimin e kontratës, ku punimet e mëparshme duhet të kenë zëra të konsiderueshme punimesh me zërat e punimeve që po prokurohen, si dhe në rastin kur punimet e mëparshme janë kryer si bashkim operatorësh ekonomikë, nuk jepet informacion mbi përqindjen e anëtarëve në bashkim, në vërtetimet që lëshojnë autoritetet kontraktor edhe në faturat tatimore të shitjes, ku këto të fundit lëshohen nga përfaqësuesi i bashkimit të operatorëve ekonomikë. Meqenëse se paraqitja e dokumentacionit të mësipërm, nuk sjell diskriminim dhe/ose kosto shtesë për operatorët ekonomikë pjesëmarrës, por i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e përvojës së duhur të tyre, duke mundësuar zhvillimin normal dhe në kohë të procedurës së prokurimit, pasi nuk ka nevojë që Autoriteti të kërkojë informacione shtesë gjatë vlerësimit të ofertave (në rast mungese të informacionit të sipërcituar), njësia e prokurimit gjykon se kërkimi i dokumentacionit përcaktuar në kushtin e mësipërm është i nevojshëm për vërtetimin e kryerjes së punëve të ngjashme.

2.3.3 Operatori Ekonomik, duhet të vetëdeklarojë (sipas Shtojcës 8 të DST), se disponon fuqinë minimale punëtore jo më të vogël se **26 (Njete e gjashte)** punonjës me kohe të plote, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit për periudhën **Janar 2024 – Mars 2024**.

Për përmbushjen e këtij kushti, kërkohet që, nga operatori ekonomik të paraqesë:

- a) Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për periudhën **Janar 2024 – Mars 2024**.
- b) Listëpagesat e punonjësve të konfirmuara nga autoritetet përkatëse sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën e kërkuar.

*Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas Shtojcës 8.

Shënim: Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumentacionit të lartpërmendur

Argumentimi : Kriteri i vendosur për disponimin e numrit minimal prej 2 punonjës, për të paktën muajin e fundit, është në zbatim të nenit 77 pika 4 e LPP-së dhe nenit 39 pika 6/c, ku numri i punonjësve i kërkuar është në përputhje me përmasat dhe specifikat e kontratës. Në përlllogaritjen e numrit të punonjësve, njësia e prokurimit ka marrë parasysh numrin e punonjësve që nevojitet për realizimin e objektit dhe afatin e kryerjes së punimeve të përcaktuar në dokumentet e tenderit, , ku në zbatim të nenit 77 pika 5 të LPP-së dhe legjislacionit tatimor, janë përcaktuar dokumentet konkrete që duhet të paraqiten nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, për përmbushjen e këtyre kushteve. Në përlllogaritjen e numrit të punonjësve përfshihen punonjësit inxhinierë, specialistë,

punonjës të kualifikuar dhe punëtorë për punime me krahë, drejtuesit e mjeteve të thjeshta apo të rënda etj., duke pasur parasysh njëkohësisht volumin e lartë të punimeve.

Gjithashtu për të vërtetuar zotërimin e fuqisë punëtore si dhe stabilitetin e saj është kërkuar edhe vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore si dhe listpagesat e punonjësve mbështetur edhe në Kreun V, Seksioni III, Neni 39, pika 8 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” sipas së cilës: *”Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”*.

Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas Specifikimeve Teknike (të cilat do publikohen së bashku me Dokumentat e Tenderit) si dhe punimet do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës.

Argumentimi: Kjo kërkesë është vendosur në mbështetje të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 3.

2.3.4 Operatorët Ekonomike, duhet të disponojnë liçensat e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë, duhet të paraqesin liçensën përkatëse të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.01.2008, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së liçensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Shqyrtimi i liçensave do të bëhet mbi bazën e rregullave të parashikuara sa më sipër. Liçensa profesionale e Operatorit Ekonomik, lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës dhe duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

Për punimet e përgjithshme të ndërtimit:

- N.P - 1 A Punime gërmimi në tokë;
- N.P - 4 A Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale)

Për punimet speciale të ndërtimit:

- N.S - 1 A Punime për prishjen e ndertimeve
- N.S - 6 A Sinjalistika rrugore jodriçuese

Operatorët e huaj, duhet të bëjnë ekuivalentimin e liçensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturas dhe Energjisë, (ose Ministrisë kompetente të kohës), Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së liçensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM- në, Nr.42, date 16.01.2008). Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit 162, datë: 23. 12. 2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr. 285, datë: 19. 05. 2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, si dhe VKM nr. 42, datë: 16. 01. 2008,

të ndryshuar, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, (lidhja 2,3 dhe 4).

Konkretisht:

- **N.P- 1 A Punime gjermimi në tokë.**

Llojet e licencave dhe klasifikimi i tyre sipas kategorive dhe niveleve (germave) përkatëse janë bërë në përputhje me natyrën e punimeve respektive dhe vlerën e përlllogaritur sipas preventivit të hartuar për këtë objekt.

Sipas VKM nr. 42, datë: 16. 01. 2008 të ndryshuar, kategoria **N.P-1 A** “Punime gjermimi në tokë”: Konsiderohen gjermimet, sistemimet dhe ndryshimet në volum të tokës të realizuara me çfarëdo lloj mjeti, pavarësisht nga natyre e terrenit që do të gjermohet ose sistemohet vegjetale, argjilore, ranore, zhavorrishte ose shkëmbore. Sipas VKM Nr. 42 datë 16.01.2008, të ndryshuar: Kjo kategori është kërkuar duke pasur parasysh se parashikohen në preventiv punimet gjermim dheu me krah dhe makineri, mbushje, ngjeshje, përforcime gjermimi, mbushje kanali, sistemim të tokës etj., Në preventiv janë parashikuar dhera të gjermuara me krahë, dhe, me makineri, të cilat konkretisht karakterizohen nga gjermim dheu toke e zakonshme, gjermim dheu me ekskavator me goma, etj. Më tej ajo mbulon të gjitha punimet që lidhen me konstruksionin e prerjeve, largimin e materialeve të papërshtatshme në hedhurina, si dhe rifiniturat e shpatit të prerjes. Këto procese janë të parashikuara në preventiv dhe në specifikimet teknike të publikuara në SPE.

- **N.P -A Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale)**

Sipas VKM nr. 42, datë: 16. 01. 2008 të ndryshuar, kategoria N.P. – 7 A Rrugë autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tramvai, metro, hekurudhë me kavo dhe pista aeroportuale. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar rrugët, pavarësisht nga shkalla e tyre e rëndësisë, autostradat, superstradat përfshirë ndërhyrjet në pika të veçanta, tunelet, devijimet nën nivele dhe nëlartësi, parkimet, punime të mureve mbajtëse, hekurudha, metro, hekurudhë me kavo, tranvai, pista aeroportuale, sheshet e helikopterëve, sheshet të realizuara me materiale të veçanta, natyrale dheartificiale, urat, si dhe komplekse karakteristikash teknike, në hekur, betonarme të thjeshtë dhe të paranderur, parafabrikat ose të prodhuar në objekt.

Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturim i ndërhyrjeve në rrjetin rrugor të nevojshëm për të ndjerë paqëndrueshmërinë mbi “goma”, “hekur”, “zona”, kushdo që të jetë shkalla e

rëndësisë, kompletimi i çdo vepre lidhëse, plotësuese ose pajisje edhe e tipit të veçantë, të linjës hekurudhore.

- **NS - 1 A Punime për prishjen e ndertimeve**

Sipas VKM nr. 42, datë: 16. 01. 2008 të ndryshuar, kategoria N.S. – 1 A Konsiderohen për prishjene e ndertimeve të cilat ndodhen objekt me qëllim rindertimin e tyre. Vendosija e kesaj pike

licence si kriter lidhet me zbatimin e punimeve te parashikuara te realizohen nepermjet kesaj procedure duke qene se vete objekti eshte nje veper vaditje dhe perfshin te gjitha zerat e nje vepre te tille. Kategoria A i referohet vleres totale te ketyre punimeve ne preventivin e projektit te zbatimit.

Niveli i klasifikimit i kerkuar per kategorite respektive, eshte kerkuar bazuar ne zerat e punimeve qe parashikohen te kryhen ne preventiv, qe perfshihen ne kategorine perkatесе brenda vlerave te kufijve te parashikuara ne VKM Nr. 42, date: 16. 01. 2008, te ndryshuar.

- **N.S - 6: Sinjalistika rrugore jodriçuese**

Sipas VKM nr. 42, date: 16. 01. 2008 te ndryshuar, kategoria **N.S – 6** Konsiderohet vendosja ne vepër, mirëmbajtja, ristrukturimi dhe kryerja e sinjalistikës rrugore jondriçuese, vertikale, horizontale dhe komplementare.

2.3.5 Staf kryesor e mbështetës, punonjësit, çertifikimet.

2.3.5/1 Operatori/ët ekonomike ofertues duhet te paraqesë/in me formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 në DST:

Se disponon në stafin e tij si Drejtues Teknik të shoqërise, inxhinierët e mëposhtëm:

- 1 (një) Inxhinier Ndërtimi
- 1 (një) Inxhinier Gjeodet/Topograf/Markshajder
- 1 (një) Inxhinier Gjeoinformatik

Inxhinierët e sipërcituar, duhet të figurojnë si **drejtues teknik në licensën** e Operatorit Ekonomik ofertues dhe në listëpagesën e shoqërisë minimumi për periudhën **Janar 2024 – Mars 2024**. Për inxhinierët, operatori ekonomik fitues duhet të paraqesë:

- Kontratat e punës (të vlefshme);
- Diplomat përkatëse;
- Të figurojnë në listëpagesën e shoqërisë minimumi për periudhën **Janar 2024 – Mars 2024**

2.3.5/2 Operatori pjesëmarrës duhet te kenë të punësuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, jo domosdoshmerisht te perfshire ne licensen e shoqerise, të vërtetuar me kontratë pune (të vlefshme), diplome, si dhe të figurojnë ne listepagesat e shoqërisë minimumi për muajt **Janar 2024 – Mars 2024**, si më poshtë:

- | | |
|--|---------|
| 1. Inxhinier Gjeoteknik | 1 (një) |
| 2. Inxhinier Ndertimi – Profili Infrastruktura-Transport | 1 (një) |

Argumentimi : Kërkesat e mësipërme bazohen në Nenin 77 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” në të cilin parashikohet: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me

objektin e kontratës. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.” Në nenin 39 “Kërkesat të veçanta për kontratat për punë publike”, pika 6 dhe 8 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” parashikohet: “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike e profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.”

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Konkretisht: Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet me objektin e kontratës dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës, me qëllimin për të pasur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Drejtuesi teknik është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës. Referuar natyrës dhe përmasave të kontratës objekt prokurimi, me qëllim ndërtimin e investimit tejet të rëndësishëm sipas projektit, në përputhje me kushtet teknike të zbatimit dhe vërtetimin e aftësisë organizative, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, njësia e prokurimit referuar zërave të punimeve që do të kryhen objekt kontrate, vlerëson se operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duhet të disponojnë stafin e drejtuesve teknik (inxhinierët) me kualifikimet e kërkuara. Kërkesa specifike për inxhinierët e kërkuar është përcaktuar në kuadër të analizës që i është bërë preventiv të punimeve (nga ku përcaktohet qartazi dhe profili inxhinierik), ku më hollësisht parashtrahet:

Jane kërkuar inxhinier ndërtimi i cili është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet, për secilin nga zërat e punimeve ndërtimore, referuar preventivave të punimeve, kontrollit të punimeve të betonit të pranishme në preventiv si: ndërtim mure betoni, pusetat beton arme, pusetat shpërndarje dhe pusetat e kontrollit etj

Jane kërkuar inxhinier gjeodet i cili është përgjegjës për zbatimin e rilevimeve topografike që kërkojnë mjete dhe organizim të veçantë, punime topogjeodezike në objekte inxhinierike etj. Kjo

eshte nje domosdoshmeri per piketimin e kanalit qe do te germohet dhe te jete sipas kuatova dhe distancave te projektit.

Jane kerkuar inxhinier gjeoinformatik i cili eshte pergjegjes per leximin dhe interpretimin e hartave dhe projekteve te objektit.

2.3.5/3. Operatori ekonomik duhet te deklarojë (*sipas shtojcës 8 të DST*) se ka minimumin punonjës specialist për kryerjen e punimeve, dhe të figurojnë në listpagesat për periudhën **Janar 2024 – Mars 2024**, si më poshtë:

- Teknik Ndërtimi	1 (nje)
- Teknik Topograf/gjeometer	1 (nje)
- Hekurthyes	1 (nje)
- Karpentier	3 (tre)
- Specialist per vendosje bordurash	1 (nje)
- Punime ne rruge dhe asfaltimi	1 (nje)
- Saldator	2 (dy)
- Bojaxhi	2 (dy)
- Automakinist	1 (nje)
- Eskavatorist	1 (nje)
- Shofer kamioni	2 (dy)

4 punetore te thjeshte ndërtimi, per te cilët te paraqite kontrata e punës si dhe te figurojnë ne listepagese minimalisht për periudhën **Janar 2024 – Mars 2024**.

Për stafin teknik ofertuesi duhet të paraqesë:

- kontratë individuale të punës;
- Çertifikatë profesionale/dëshmi që vërteton kualifikimin profesional, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit Nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë.

Argumentimi :Janë kerkuar punonjës të specializuar dhe të certifikuar, me qëllim ndërtimin e investimit tejet të rëndësishëm, sipas projektit në përputhje me kushtet teknike të zbatimit dhe vërtetimin e aftësisë organizative, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën;

Konkretisht janë kerkuar:

- **Teknik ndërtimi dhe topograf** , të cilët janë të nevojshëm për ndjekjen e realizimit të punimeve të ndërtimit, duke pasur parasysh punime ndërtimore qe do të kryhen sipas zërave të preventivave të punimeve, mur tulle për puseta, bordura betonarme etj.
- Punonjës **hekurkthyes dhe saldator** janë kerkuar për të realizuar kthimet e hekurit, kornizat e hekurit në armaturat e betonit në punimet e betonit. Këta punonjës realizojnë

kthimet e hekurit, kornizat e hekurit në armaturat e betonit në punimet e betonit dhe shtresë betoni. Specialistët hekurkthyes presin, përkulin dhe vendosin rrjeta teli në strukturat e betonit, bëjnë planet e punës në lidhje me strukturat e hekurit dhe betonit.

- Specialist për vendosjen e bordurave janë kërkuar për të realizuar vendosjen e bordurave sipas kërkesave të preventivit.
- Punonjes bojxhi janë kërkuar për të realizuar punimet e bojatisjes sipas kërkesave të preventivit.
- Punonjesit për Punime në rruge dhe asfaltimi janë kërkuar për të realizuar punimet e asfaltimit dhe betonimit.
- **Specialistët karpentier** janë kërkuar për të realizuar punimet e armaturave në beton duke pasur parasysh volumin e punimeve me hekur beton (referuar preventivit). Është e nevojshme për prerjen dhe montimin e strukturave prej druri, si dhe ndërtimin e kornizave dhe strukturave të tjera përforcuese prej druri apo materiale të tjera, të nevojshme për realizimin e objektit që do të ndërtohet.
- **Specialistët** punonjes manovrator dhe shofer janë kërkuar për të realizuar punimet nepermjet makinerive të domosdoshme të cilat do të shërbejnë për krijimin e hapësirave duke bërë zgjerimin e kanalit ujites, si dhe transportimin e materialeve të ndryshme.

Argumentimi:

Kërkesat e mësipërme bazohen në piken 4 Nenin 77 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” neni 39 pika 6/c të VKM nr. 285 dt. 19. 05. 2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku kërkohet që OE të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar, si dhe bazuar në rregullore “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e dëshmisë së aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre” miratuar me urdhrin nr. 200 dt. 16. 05. 2019 të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjitikës.

Punetoret e thjeshta, janë kërkuar për realizimin e punimeve të thjeshta që nuk kërkojnë njohuri specialiste.

2.3.6 Operatori ekonomik, duhet të ketë të paktën minimalisht **1 (një) punonjës**, në stafin i tij, që të disponojë dëshmi trajnimi si “**Kordinator për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë**” në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10327 datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe VKM Nr. 312 datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”.

Për përmbushjen e këtij kushti duhet të paraqiten, çertifikata e trajnimit për “**Kordinator për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë**”, e dhënë nga një organizëm i licencuar, kontrata e punës, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën **Janar 2024 – Mars 2024**, (Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të paraqesë 1 (një) punonjës “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë” në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrë e pjesëmarrjen në punë, shërbim apo furnizim, të percaktuara në aktet marrëveshje).

Argumentimi :Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht :

Kërkesa e mësipërme mbështetet në ligjin nr. 10327 datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”. Natyra e kontratës dhe specifikat e saj kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr. 312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ofrojë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënës zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes.

Ky kusht do të plotësohet nga operatorit Ekonomik tek formulari i vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8 në DST.

2.3.7.Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve Objekt kontrate, duhet të paraqesë vetëdeklarimin sipas shtojcës 8 të DST, FormulariPërmbledhës i Vetdeklarimit, ku të deklarojë se disponon mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Nr.	Lloji i makinerive	Statusi	Njësia	Sasia
1	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 20 ton	Në pronësi ose me qira	Copë	1
2	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës deri 10-20 ton	Në pronësi ose me qira	Copë	1
3	Kamioncina me kapacitet mbajtës 1.5 deri 3 ton	Në pronësi ose me qira	Copë	1
4	Eskavator me goma (me targa) (MT)	Në pronësi ose me qira	Copë	1
5	Kamion me vinc me kapacitet ngrites 3.5 t me gjatesi krahu min 10 m	Në pronësi ose me qira	Copë	1

6	Rimorkiator për transportin e mjeteve	Në pronësi ose me qira	Copë	1
7	Fadromë kovë para dhe mbrapa (me targa) (APV)	Në pronësi ose me qira	Copë	1
8	Eskavator me zhinxhir + cekic	Në pronësi ose me qira	Copë	1
9	Autobetoniere	Në pronësi ose me qira	Copë	1
10	Autopompë	Në pronësi ose me qira	Copë	1
11	Asfaltoshtruese	Në pronësi ose me qira	Copë	1
12	Gjeneratorë	Në pronësi ose me qira	Copë	1
13	Rrul per ngjeshje shtresash	Në pronësi ose me qira	Copë	1
14	Autobetoniere vetengarkuese min 2 m3	Në pronësi ose me qira	Copë	1
15	Vibrator betoni	Në pronësi ose me qira	Copë	2
16	Matrapik per prishje	Në pronësi ose me qira	Copë	2
17	Depozita Uji 5000 L	Në pronësi ose me qira	Copë	2
18	Kthyesë Hekuri-Bango hekuri	Në pronësi ose me qira	Copë	1
19	Kontenjer (zyre)	Në pronësi ose me qira	Copë	1
20	Elektro saldatrçe	Në pronësi ose me qira	Copë	1
21	Armaturë/betoforma/lendë drusore	Në pronësi ose me qira	m2	500
22	Damper kantieri	Në pronësi ose me qira	Copë	2
23	Autobot uji	Në pronësi ose me qira	Copë	1
24	Stampa betoni	Në pronësi ose me qira	cope	20

* Ky dokumentacion, përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas *Shtojcës 8 të DST-së*.

A. Ofertuesi për makineritë, të cilat janë në pronësi ose me qera, duhet të paraqesë, dokumentacionin e mëposhtëm :

Për mjetet që janë në pronesi, duhet të paraqitet :

- a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi);
- b) certifikata e vlefshme e kontrollit teknik (SGS);
- c) siguracioni (polica e sigurimit) i vlefshëm i mjetit;
- d) certifikatë transporti

Kur janë me qera, duhet të paraqitet :

- a) kontrata e qerasë;
- b) certifikata e vlefshme e kontrollit teknik (SGS);
- c) siguracioni (polica e sigurimit) i vlefshëm i mjetit;
- d) Certifikata e transportit për të tretë ose në emër të qeramarrësit lëshuar nga Bashkia ose D.P.SH.T.RR (e vlefshme).

Për mjetet apo pajisjet e tjera që nuk pajisen me leje qarkullimi, ofertuesi duhet të paraqesë kontratë noteriale të blerjes ose fatura tatimore të blerjes ose dokument zhdoganimi të mjetit dhe foto të tyre.

Autoriteti Kontraktor, rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të vetëdeklaruar (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese) sipas Shtocës Nr. 8 të DST-së. Në rast deklarimi të rremë, do të veprhet në përputhje të Ligjit Nr.162/2020 datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

Operatori/et ekonomik ofertues, duhet të deklarojë që, të gjitha mjetet dhe pajisjet e përshkruara në pikën 2.3.20 të Kapacitetit Teknik, do të jenë të angazhuara vetëm në këtë kontratë. Mjetet të cilat rezultojnë të angazhuara në kontrata të tjera, afati i zbatimit të të cilave shtrihet përgjatë afatit të kontratës objekt prokurimi, janë shkak skualifikimi. Autoriteti Kontraktor, gëzon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë disponueshmërinë e këtyre mjeteve, si gjatë vlerësimit të ofertave, ashtu edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në rast deklarimi të rremë, do të veprhet në përputhje të Ligjit nr.162/2020 datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik“:

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtocës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

B)Licence per transport mallrash per te trete dhe me qira brenda vendit (e vlefshme) :

C) Mjete dhe paisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit në zbatim të VKM Nr. 312 datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier” i ndryshuar, si më poshtë vijon duhet të disponojë :

- Kokore, minimumi 26 copë;
- Jeleke Fosforeshente, minimumi 26 copë;
- Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secila, minimumi 5 copë;
- Prozhektorë ndriçimi natën, minimumi 5 copë;
- Kompleti ndimës së shpejtë, minimumi 5 copë;
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt, minimumi 5 copë.

Ky kusht do të plotësohet nga operatorit Ekonomik tek formulari i vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8 në DST.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77 pika 4 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik1” në të cilin përcaktohet: Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Në nenin 39 pika 6 d “Kërkesat të veçanta për kontratat e mallrave” pika 6/d të VKM Nr. 285 datë 19.5.2021 parashikohet: *“Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon... mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.”*

Këto mjete dhe pajisje referuar preventivit të punimeve janë të nevojshme për realizimin e punimeve, ndaj njësisia e prokurimit vendosi që të kërkojë që operatorët ekonomike të disponojnë mjetet dhe pajisjet e mësipërme sepse ato nevojiten për kryerjen e punimeve dhe janë në përpjesëtim me objektin e kontratës.

Për të përcaktuar llojin dhe numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë bazuar sipas zërave të preventivit dhe specifikimeve teknike të hartuara nga specialistet e fushës. Çdo mjeti kërkuar përkon me proceset ndërtimore sipas zërave përkatës të preventivit. Numri i makinerive është përcaktuar duke marrë në konsideratë volumet e punimeve për secilin zë pune mbështetur kjo në VKM Nr. 629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre”. Dokumentacioni shoqëruar i kërkuar për makineritë, provon certifikimin ligjor dhe teknik të mjeteve të disponuara nëpërmjet kontratës së shitjes apo kontratës së qirasë. Ky dokumentacion i jep garanci autoritetit kontraktor se punimet do të realizohen me cilësi, siguri dhe në respektim të grafikut të punimeve. Në mbështetje të dispozitës ligjore të sipërcituar Ligjvënësi i jep të drejtën Autoritetit Kontraktor të kërkojë nga ana e Operatorëve ekonomike dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike. Njësisia e Prokurimit ka vlerësuar si të domosdoshëm paraqitjen e deklaratave dhe dokumentacionit përkatës në lidhje me mjetet dhe pajisjet teknike që Operatori ekonomik disponon në funksion të realizimit të kontratës objekt prokurimi. Çdo mjet i përcaktuar në procedurën e prokurimit është kërkuar në funksion të kryerjes së zërave specifike të punimeve, ndërsa numri i mjeteve është përcaktuar në varësi të volumeve të punimeve dhe kohës së realizimit të tyre. Përsa më sipër, numri i mjeteve është përcaktuar në bazë të nevojës pasi objekti zhvillohet në një kohë të shkurtër, pa cenuar grafikun e përcaktuar të punimeve dhe, veç të tjerash, objekti ka një shtrirje të konsiderueshme gjeografike, prandaj do të punohet në disa fronte pune njëkohësisht, për të kapur afatet e përcaktuara. Në lidhje me kriterin për disponimin e makinerive dhe pajisjeve, njësisia e prokurimit vlerëson se referuar përmasave dhe

volumit të punimeve objekt kontrate, operatorëve ekonomike u lind e nevojshme disponimi i makineri pajisjeve.

Makineritë kamion vetëshkarkues dhe kamionçinat, janë kërkuar për transportin e materialeve që do të dalin gjatë gërmimeve sipas kërkesave në preventiv, ku ka gërmime si edhe transport dheu në volume të konsiderueshme. Gjithashtu ky proces do të vazhdojë me sistemime, mbushje ngjeshje, drenazhime dhe largim të ujërave etj.

Mjetet tip Ekskavator me goma dhe fadrome me goma, janë kërkuar sipas kërkesave të preventivit.

Ndërsa mjetet dhe pajisjet të mbrojtjes në punë të punëtorëve, si dhe të personelit, janë kërkuar në zbatim të kërkesave të VKM Nr. 312 datë: 05.05.2010 “Për miratimin e Rregullores për sigurinë në kantier”. Njësia e prokurimit vlerëson se pa këto mjete një operator ekonomik nuk mund të realizojë punët e parashikuara në këtë objekt prokurimi. Ruajtja dhe siguria në punë të jetëve njerëzore, është përparësi dhe detyrim ndaj punonjësve.

Shënim: Makineritë dhe pajisjet, janë kërkuar në bazë të specifikës së punës, volumit dhe punimeve paralele në katër fronte me shtrirje të gjerë gjeografike, kjo sipas gjurmëve dhe zbatimit të projektit të miratuar për punimet në terren.

2.3.8. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se e zhvillojnë aktivitetin e tij në fushën objekt prokurimi në përputhje me standardet e menaxhimit të cilësisë, të shëndetit e sigurisë në punë dhe mjedisit. Për këtë duhet të paraqesin certifikatat e mëposhtme:

- Çertifikatë **ISO 9001:2015** mbi “*Sistemet e menaxhimit të cilësisë*”, lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituara për këtë qëllim (ose te njevlëshme me to).
- Çertifikatë **ISO 14001:2015** mbi “*Sistemet e menaxhimit të mjedisit*”, lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituara për këtë qëllim (ose te njevlëshme me to).
- Çertifikatë **OHSAS 45001-2018** mbi “*Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë*” lëshuar nga Institucionet zyrtare të akredituar për këtë qëllim për mbrojtjen e shëndetit dhe sigurisë në punë (ose te njevlëshme me to).

Certifikatat si më sipër duhet të paraqiten origjinale ose kopje të noterizuara, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose

organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Certifikatat duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën ISO sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes.

Argumentimi: Referuar VKM-së nr. 285, datë 09.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, neni 44 “Kërkesat e cilësisë”, pika 1 si dhe Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 79, Autoriteti Kontraktor, ka të drejtë të kërkojë certifikata të lëshuara nga një organ i akredituar ose organizma ndërkombëtarë, me qëllim që, operatorët ekonomikë që do të zbatojnë kontratën, të jenë certifikuar në sistemet e menaxhimit të cilësisë, të mjedisit, të shëndetit dhe sigurisë në punë si dhe menaxhimin e integruar, në përputhje me objektin e kësaj kontrate dhe e nevojshme për objektin e prokurimit, të cilën AK kërkon ta kryejë me cilësi dhe në kohë.

Duke parë objektin e prokurimit, preventivin dhe vlerën e saj, autoriteti kontraktor është në të drejtën e tij që të kërkojë certifikata të cilësisë në përputhje me objektin e prokurimit, që përpos punimeve që do të kryhen nga operatorët ekonomik ofertues, këto punime të kryhen me cilësi sipas certifikatës ISO të mësipërme.

Autoriteti Kontraktor, përpos punimeve që do të kryejë, kërkon që këto punime ti zhvillojë në përputhje dhe garanci të plotë me sigurinë dhe shëndetin në punë të punonjësve. Kjo certifikatë garanton sigurinë dhe shëndetin në punë të punonjësve që marrin pjesë gjatë një procesi, kryerjes së një veprimtarie apo pune publike e cila vë apo mund të vërë në rrezik shëndetin dhe jetën e punonjësve.

Në rastet e bashkimit të O.E, secili nga anëtarët e bashkimit të grupit duhet të plotësojë kërkesën e mësipërme, në përputhje me zërat e punimeve që ka marrë përsipër të realizojë sipas Akt Marrëveshjes së Bashkëpunimit.

Certifikatat si më sipër duhet të paraqiten origjinale ose kopje të noterizuara, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Certifikatat duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën ISO sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes.

2.3.9. Në përputhje me specifikimet teknike si dhe preventivit perkates, operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim/kontrate bashkëpunimi/furnizimi nga prodhuesi/distributori, me të cilin prodhuesi/distributori autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertojë këto pajisje/mallra

në këtë procedurë prokurimi, si më poshtë:

- Bordura Betoni
- **Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.
- Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

***Shënim:** Operatorët ekonomik gjatë plotësimit të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8, duhet të kenë parasysh përcaktimet e dokumentit “Sjellje në Vëmendje”, Nr. 918 prot., datë 02.02.2022, të publikuar në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik.

***Shënim:** Të gjitha dokumentat e kërkuara më sipër si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës të dorëzuara në rrugë elektronike, duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet Teknike për procedurën respektive janë hartuar nga drejtoria e projekteve, pjesë perberese e strukturaes së **Ndermarrja Pastrim Gjelberim e Treg Kamez**, që ka hartuar edhe projektin perkates te zbatimit duke gene elemente perberes te tij. Ne hartimin e tyre jane marre ne konsiderat kerkesat ligjore te fushes se planifikimit dhe zhvillimit te territorit si dhe normat perkatese te Ligjit nr. 9290 , date 7.10.2004 “Për produktet e ndërtimit” i ndryshuar dhe Vendim i KM nr.312, datë 5.5.2010 Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier” si dhe kerkesat e

ligjit te Ligjit Nr. 10480 datë 17.11.2011 , "Për sigurinë e përgjithshme të produkteve joushqimore".

Specifikimet Teknike jane pjese e setit te dokumentave te ngarkuara ne SPE per proceduren respektive.

Fondi Limit i perlogaritur per kete procedure eshte hartuar ne baze te te Vkm nr. 216 date 13.04.2023''Per Miratimin e Manualeve Teknike te Cmimeve te Ndertimit dhe analizat teknike te tyre'',

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj"**.*

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët "ose ekuivalente".

Njësia e prokurimit